

## TEVHIDI DHE FAMILJA \*

### I. RËNIA E INSTITUCIONIT TË FAMILJES NË BOTË

Të inspiruar nga doktrinat e tyre lidhur me origjinën e shoqërisë, komunistët qëllimisht planifikuan që familjen ta zëvendësonin me komunën. Komunistët, kushtet ideale të jetës njerëzore i pikturuan si të tilla ku njerëzit jetojnë nëpër fjetore/konvikte, hanë nëpër mensa dhe fëmijët e tyre i konsiderojnë si të shtetit. Edhe pse u krijuan shumë komuna, komunistët shpejt kuptuan se metoda kolektive e organizimit personal ishte e detyruar të dështonte dhe se forma tradicionale e familjes vazhdonte të funksiononte. Kjo dalje zot e shtetit për shumë disa detyra që zakonisht i ndërmarrin prindërit ndaj fëmijëve, pa kurrfarë dashurie dhe interesi për ta, vetëm sa e ka dobësuar lidhjen familjare. Sot, mezi gjen ndonjë bazë mbi të cilën anëtarët e familjes do të mund t'i ngrinin marrëdhëniet e tyre, përpos kujtesës për varshmërinë dhe shoqërimin gjatë fëmijërisë.<sup>1</sup>

Në Evropën Perëndimore dhe në Amerikën e Veriut, vërshimi drejt qendrave urbane për të kërkuar punë, çdokënd e ka bërë anonim (të panjohur). Përzierja e gjinive, morali i shturur, pavarësia ekonomike e femrave, damka e fortë e individualizmit dhe absolutizimi tradicional i natyrës nga brenda, të gjitha kanë kontribuar në drejtim të brejtjes së lidhjes familjare. Shturja dhe përzierja e sekseve gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli (XX), shpreh gjendjen e trishtuar të punëve në të cilat është fundosur institucioni i familjes. Për momentin, tepër se gjysma e fëmijëve të lindur nëpër qytete të mëdha janë jashtëligjorë. Familja është shndërruar në kafshë, në kuptimin se ajo zgjat aq sa fëmijët fizikisht janë të pamundshëm dhe kanë nevojë të vazhdueshme për kujdesin e prindërve të tyre. Sapo të rriten, nevoja materiale zhduket kurse lidhja familjare shturet. Për më keq, zënia e prindërve me punë jashtë shtëpisë, rraskapitja e tyre fizike si dhe presioni që kanë për të kërkuar kënaqësinë emocionale jashtë shtëpisë, e dobësojnë lidhjen familjare bile edhe atëherë kur fëmijët janë akoma në moshë të njomë. Familja, siç po merret vesh, praktikisht është shtrirë në shtratin e vdekjes.<sup>2</sup>

Edhe antropologët e kanë ndihmuar rrënimin e institucionit të familjes duke treguar se edhe forma të tjera të bashkimit njerëzor janë të mundshme dhe se kanë qenë të suksesshme ndër kafshët e njerëzit primitivë. Referimi i vazhdueshëm në botën shtazore me rastin e shqyrtimit të sjelljes njerëzore, ka bërë shpëlarjen e kokave të njerëzve duke pohuar se dallimet prej kafshëve

---

\* Ky artikull përbën kapitullin IX të librit *Tevhidi: implikimet e tij për mendimin dhe jetën*, të autorit Dr. Ismail Raxhi el-Faruki, Logos-A, Shkup 2006, f. 231-247.

<sup>1</sup> Shih, për shembull, Norman W. Bell dhe Ezra F. Vogel (editorë), *The Family*, Glencoe, Illinois: The Free Press, 1960, kapt. IV.

<sup>2</sup> William F. Kenkel, *The Family in Perspective*, Nju Jork: Meredith Corporation, 1973, kapt. V, XII.

nuk janë të natyrshme; kurse vërshimi i teorive të tyre spekulative sipas të cilave format devijuese të organizimit njerëzor, si matriarkati, poliandria etj., fillimisht kanë qenë mbizotëruese, kanë kontribuar drejt shkëlqes së familjes nga pozita e saj e nderit dhe e domosdoshmërisë.

Përgjatë gjithë botës komuniste dhe Perëndimit, institucioni i familjes ka pësuar ndryshime rrënjësore. Ajo sot, në mënyrë të pazgjidhshme, identifikohet me zvetënimin e përgjithshëm të shoqërisë. Ajo ndikon dhe ndikohet nga rënia e moralit, e kohezionit shoqëror, e vazhdimit të traditave nëpër gjenerata. Pa marrë parasysh se cili është shkaku e cila pasoja, qytetërimi dhe familja duket se e kanë të shkruar të ngrihen së bashku e të bien së bashku. Boa muslimane dhe pjesa tjetër e Botës së Tretë, për sa ka të bëjë me ruajtjen e identitetit të tyre prej sulmeve të ashpra të komunizmit e të ideologjive perëndimore, janë të vetmet shoqëri që kanë mbetur ku familja akoma e ruan pozitën e saj të nderit. Institucioni islam i familjes ka mundësitë më të mira për të mbijetuar, ngase përkrahet nga e drejta islame dhe determinohet nga relacioni i ngushtë i saj me *tevhidin*, esencën e përvojës fetare islame.

## II. FAMILJA SI NJËSI PËRBËRËSE E SHOQËRISË

Plotësimi i qëllimit të Zotit prej njerëzimit kërkon që ata të martohen, të riprodhohen e të jetojnë së bashku dhe kështu ta sigurojnë teatrin e marrëdhënieve ku pjesa morale e vullnetit hyjnor do të mund të përmbushej përmes vendimit dhe veprimit njerëzor. Ky teatër mund të përbëhet prej katër niveleve, gjegjësisht, prej vetvetes, prej familjes, prej fisit-kombit-racës dhe prej *ummetit* universal. Nevoja për nivelin e parë është më se e qartë. Çfarëdo përmbushje e çfarëdo moraliteti kërkon futjen e subjektit në një marrëdhënie etike me vetë vetveten e tij. Ta njohësh këtë vetvete, ta ruash e ta ndihmosh atë si dhe t'ia nënshtrosh determinimit nga ana e vlerave morale, janë kushte pa të cilat vetë krijesat do të qorrrolliseshin. Niveli i tretë, respektivisht fisi, kombi a raca, nuk është i domosdoshëm. Ka të njëjtën natyrë me të *ummetit*, nga aspekti se krijon lidhje me njerëzit e tjerë me të cilët nuk ka lidhje biologjike apo lidhje të largët që, në vend të ndjenjës së drejtpërdrejtë, i nënshtrohet imagjinatës. Nga ky këndvështrim, niveli i fisit (kombit a racës) është vetëm kufizues, ngase nuk i shton asgjë marrëdhënies që individi mund ta ketë me *ummetin*. Funkcioni i tij është që këtë marrëdhënie t'ua kufizojë anëtarëve të fisit (kombit a racës) dhe, si të thuash, ta pengojë shtrirjen e anëtarësisë të të tjerët. *Ummeti, per vontra*, këtë lidhje e mbështet në fe apo ideologji dhe anëtarësinë e tij e shtrinë te të gjithë "nënshkruesit" pa marrë parasysh lindjen a dallimet shoqërore, si gjuhën, historinë apo ngjyrën.<sup>3</sup> Marrëdhënia e *ummetit* është më humane dhe e ruan dinjitetin e personit, për dallim prej marrëdhënies së fisit (kombit a racës) e cila e shkel këtë dinjitet duke e mbështetur ekskluzivizmin e saj në dallimet prej lindjes. Kjo është arsyeja përse Islami e ka suprimuar fisin/kombin/racën si bazë për marrëdhënie dhe e ka zëvendësuar me *ummetin* universal.<sup>4</sup> Tribalizmi ka mbizotëruar në periudhën para-islame të injorancës e prapambetjes, kurse fëmija

<sup>3</sup> "Ky është **ummeti** juaj një dhe i vetëm, kurse Unë jam Zoti juaj, prandaj adhuromëni Mua!" (el-Enbija':92); "Dhe le të ketë nga ju një **ummet** që do të thërrasë në të mira dhe do të kërkojë të bëhen punë të mira e do të pengojë nga veprat e këqija. Ata do të jenë të shpëtuar" (Alu Imran:104).

<sup>4</sup> "Ky është **ummeti** juaj një dhe i vetëm, kurse Unë jam Zoti juaj, prandaj frikësomuni Mua! Mirëpo, ata u ndanë në grupe përkitazi me çështjet fetare, secila palë e entuziazmuar me atë çka kishte (predikonte). Prandaj, lërinia ata në mashtrimin e vet deri dikur!" (el-Mu'mininun: 52-54); "Kur ata që nuk besuan mbushën zemrat e tyre me arrogancë, arrogancë të paganizmit, All-llahu lëshoi qetësinë e vet mbi Pejgamberin dhe mbi besimtarët dhe i obligoi ata me fjalën e 'takvasë' (devotshmërisë, shehadetit), ndërsa All-llahu i di të gjitha" (Fet'h:26).

i tij, nacionalizmi apo racizmi, ka qenë kriter dominant në perandoritë romake dhe persiane që i paraprinë Islamit dhe të cilave Islami ua ka dhënë *coupe de grâce*-n. Ato kanë qenë përgjegjëse për të keqen e këtillë në punët e njerëzve dhe ato duhej të çrrënjoseshin.

Kjo, familjen e lë të vetme si njësi të skajshme të shoqërisë, e rrethuar nga individi, në njërën anë, dhe nga *ummeti* universal, në anën tjetër. Rëndësia e saj në rendin kozmik është theksuar në Kur'an: "Edhe një argument tjetër i Tij është se Ai, nga lloji juaj, krijon bashkëshorte që të gjeni prehje pranë tyre dhe ndërmjet jush mbjell dashuri dhe mëshirë".<sup>5</sup> Islami nuk e dënon seksin, atë e konsideron si të pafajshëm, të domosdoshëm e të mirë dhe jo vetëm që nuk e ndalon, por porositi që burri e gruaja plotësimin e njëri-tjetrit ta kërkojnë tek ai.<sup>6</sup> Megjithëkëtë, ai nuk e njeh atë vetëm si përmbushje të qëllimit të martesës. Atë martesë që mbështetet pastër në seks, në sindromën e dashurisë të romantizmit, ai e shpall të papërkryer e të paplotë.<sup>7</sup> Martesa krijon një kompleks të gjerë marrëdhëniesh njerëzore të cilat janë lëndë e pjesës më të madhe të imperativit moral. Detyrat e riprodhimit, dashurisë, përkrahjes, këshillimit, udhëzimit, arsimimit, ndihmës, miqësisë etj., janë detyrat e para të personit ndaj anëtarëve të familjes së tij. Kategoria *dhū kurbā* (farefisi) shfaqet shumë dukshëm në urdhëresat shoqëror të Zotit në Kur'an.<sup>8</sup> Shkurt, mund të thuhet se Islami familjen e konsideron si të domosdoshme për përmbushjen e qëllimit hyjnor dhe nuk mund të ketë *tevhid* pa një përmbushje të këtillë, sepse ta njohësh All-llahun xh.sh. si një Zot të vetëm, do të thotë ta njohësh Atë si një Qenie, vullneti dhe urdhri i së Cilës përbëjnë nevojën, të mirën dhe qëllimin e njeriut. Ta përkrahësh *tevhidin*, do të thotë që urdhrin e Zotit ta ndjekësh si të domosdoshëm, kurse të veprosh kështu, do të thotë të kërkoresh t'i kuptosh lëndët reale që i aktualizojnë vlerat e fshehura në këta urdhra. Të gjitha këto janë të lidhura logjikisht me njëra-tjetrën dhe janë të pandashme. S'është e mundur ta përmbushësh njërën pa e përmbushur edhe tjetrën. Zoti, në fakt, jo vetëm që e ka urdhëruar realizimin e këtyre vlerave, por edhe e ka treguar metodën dhe i ka përcaktuar saktë lëndët për këtë realizim. Këto janë familja dhe marrëdhëniet që i shkakton ajo. Domosdoshmëria e këtyre dyjave mund të përdëftohet në mënyrë racionale. Përcaktimi i tyre nga ana e Zotit është konfirmim i domosdoshmërisë së tyre racionale. Prandaj, nuk mund të ketë *tevhid* pa familjen.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> Er-Rum:21.

<sup>6</sup> "Gratë tuaja janë si arat tuaja, prandaj silluni me arat tuaja si të dëshironi, por përgatituni për vete dhe frikësohuni prej All-llahut dhe dijeni se do të dilni para Tij. Pra, përgëzoji besimtarët!" (el-Bekarah:223); "...Burrat e tyre kanë të drejtë, derisa ato presin, t'i kthejnë nëse dëshirojnë pajtim. Edhe ato kanë po aq të drejta sa edhe obligim..." (El-Bekarah:228).

<sup>7</sup> "Silluni mirë me gratë tuaja dhe jini të butë ndaj tyre, sepse ato janë partnerët dhe ndihmësit tuaj besnikë! Rikujtoni se ato i keni marrë si bashkëshorte dhe e keni shfrytëzuar mishin e tyre nën emanetin e All-llahut dhe me lejen e Tij!" (M. Hejkeli, *The Life of Muhammad*, "Haxhi lamtumirës", f. 486.

<sup>8</sup> Siç dëshmon numri i madh i ajeteve ku përmendet shprehja **kurbā** (2:77; 4:7 etj.).

<sup>9</sup> Familja është e vetmja fushë të cilën shpallja kur'anore e ka parë të domosdoshme ta rregullojë edhe me parime të përgjithshme edhe me përcaktime mjaft të hollësishme, siç dëshmojnë ligjet kur'anore të martesës, shkurorëzimit dhe trashëgimisë. Në fushat e tjera (pra, në atë politike, ekonomike) Kur'ani sjell parime të përgjithshme, por shumë pak ose aspak hollësi normative.

### III. PROBLEMET BASHKËKOHORE

#### A. BARAZIA

Nuk mund të ketë dyshim se All-llahu xh.sh. meshkujt dhe femrat i ka bërë të barabartë në të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre fetare, etike dhe civile.<sup>10</sup> Megjithëkëtë, ka shumë pak përjashtime që kanë të bëjnë me funksionet e tyre të atësisë e të amësisë. Në nivelin fetar, All-llahu xh.sh. barazinë e tyre e ka konfirmuar në ajetet 3:195, 9:71-72 dhe 16:97. Të njëjtat ajete e konfirmojnë edhe barazinë e tyre etike. Barazia e tyre civile është lëndë e ajeteve 60:12, 5:38, 24:2 dhe 4:32. Për sa i përket thënies se Islami e mbështet pabarazinë, në bazë të ajetit 4:34, nuk është çështje e shqyrtuar mirë. Së pari, ajeti ka një kontekst vetëm shtëpiak. Prova për këtë qëndron në pjesën e mbetur të të njëjtit ajet që ka të bëjë me kushtet e zbatimit të pjesës së parë, që, të gjitha kanë të bëjnë me lidhjen shtëpiake. Kjo gjysma tjetër e ajetit zakonisht lihet jashtë argumentit me qëllim që t'i hapet rrugë përgjithësimi të pajustificuar. Në këtë kontekst, meshkujt vërtet kanë përparësi, ngase patriarkati është e vetmja formë e jetës familjare që njerëzimi e ka provuar dhe kultivuar qysh nga krijimi. Familja është një shtëpi / vatër që kërkon mbrojtje, kurse lufta e plotë për ekzistencën e saj që zhvillohet jashtë shtëpisë është një domosdoshmëri. Është e qartë se meshkujt janë më të prirë se femrat për ta kryer këtë detyrë. Së dyti, ta interpretosh këtë ajet sipas modës së "avokatëve" të pabarazisë, do të thotë të biesh ndesh me të gjitha ajetet e lartpërmendura të cilat e konfirmojnë barazinë në nivelet kryesore (vendimtare) të jetës fetare, etike dhe civile.

#### B. DIFERENCIMI I ROLEVE

Islami, mashkullin dhe femrën i konsideron si të krijuar me funksione të ndryshme, por ama që e plotësojnë njëri-tjetrin.<sup>11</sup> Funksionet e amësisë, si kujdesi për shtëpinë e mirërritja e fëmijëve, si dhe ato të atësisë, si mbrojtja e shtëpisë, fitimi për jetesë dhe përgjegjësia e përgjithshme, kërkojnë përbërje të ndryshme fizike, psikike dhe emocionale të mashkullit dhe femrës. Këtë diferencim Islami e bekon si të domosdoshëm për vetëplotësimin e të dyja gjinive.<sup>12</sup> Diferencimi i roleve është diçka shumë larg diskriminimit dhe segregacionit. Të dyja rolet u nënshtrohen njësoj normave fetare e etike dhe të dyja kërkojnë gjithë inteligjencën, talentin, energjinë dhe vetëpërpjekjen që mund ta mbledhin subjektet. Po kështu, ky diferencim i roleve nuk thotë asgjë për fushat e veprimit ku dyzohen ato të meshkujve e të femrave, po as për ato fushat e tjera ku nuk bëhet fjalë për dyzimin. Atje ku prirja natyrore e bën të dëshirueshme apo atje ku domosdoshmëria e bën të volitshme, veprimtaritë e meshkujve dhe të femrave mund të kalojnë në zonat e njëri-tjetrit pa mos e dëmtuar diferencimin bazë të roleve të caktuara në natyrë nga

---

<sup>10</sup> "Atij që bën mirë, qoftë mashkull apo femër, e që është besimtar, Ne do t'i mundësojmë të çojë jetë të mirë, dhe vërtet, do ta shpërblejmë me dhuratë më të mirë se sa ka punuar" (en-Nahl:97).

<sup>11</sup> "Dhe mos lakmoni atë me çka All-llahu i ka dalluar disa prej jush! Meshkujve u takon dhurata për atë që punojnë, kurse femrave dhurata për atë që ato e kanë merituar. Kërkoni mirësi prej All-llahut, se All-llahu, pa dyshim, di çdo gjë" (en-Nisa':32).

<sup>12</sup> "Dhe Zoti i tyre u përgjeggj: 'Asnjë punëtori nga ju nuk do t'ia humbë mundin e vet, qoftë mashkull apo femër – ju jeni njëri nga tjetri'" (Alu Imran:195).

ana e Zotit. Përndryshe, Kur'ani nuk do t'u garantonte femrave të gjitha të drejtat civile që ua ka dhënë dhe për të cilat s'pyetet askush.

### C. EKSPOZIMI DHE IZOLIMI

Nuk mund të ketë dyshim se All-llahu xh.sh. nuk ka dashur që femra muslimane ta veçojë veten prej shoqërisë pas një veloje apo brenda mureve të një haremi. Dëshmi për këtë është njohja e të drejtës së saj për pjesëmarrje në qeverisje, si në ajetin 60:12, në jetën publike – ajeti 9:71-72, po bile edhe në luftë – ajeti 3:195. është e qartë se pjesëmarrja ë këtille bie ndesh me izolimin dhe mbulimin me velo dhe nuk mund të paramendohet me to. Atë që Islami me gjithë forcën mundohet ta shmangë është ai lloj i ekspozimit (zbulimit) që të çon drejt imoralitetit dhe kurvërisë.<sup>13</sup> Këtu ka dy urdhra: një i përgjithshëm, që u drejtohet të dyve edhe mashkullit edhe femrës me të njëjtin theks, në mos më shumë për mashkullin pasi ajeti atë e përmend fillimisht;<sup>14</sup> dhe tjetri, që ka të bëjë vetëm me femrën dhe i cili gjendet në të njëjtat ajete të lartpërmendura, respektivisht në ajetet 24:30-31. është e vërtetë se Kur'ani kërkon prej femrave që të mbulohen, mirëpo ai qartë i ka përjashtuar nga kjo ato pjesë që zakoni do t'i zbulonte kur femrat do t'i ushtronin profesionet dhe prirjet e tyre ashtu siç ua ka përshkruar Islami. Zbulimi i paramenduar i bukurisë dhe i stolisë femërore vërtet të çon të tundim (ngasje, joshje), ndaj për këtë arsye, edhe është i ndaluar, përveç ndaj të miturve dhe atyre të rriturve me të cilët nuk mund të hyjë në marrëdhënie martesore, si babai, vëllai, biri ose xhaxhai i saj.<sup>15</sup> Mënjanimi i tundimit është një ideal i lartë etik. Ajo s'ka të bëjë asgjë me përmbushjen e detyrave të saj islame në shoqëri. Për më tepër, femrat janë shfaqur pandërprerë me fytyra, duar dhe këmbë të pambuluara gjatë kryerjes së këtyre funksioneve islame qysh nga ditët e Pejgamberit a.s. dhe në vetë Tempullin e Shenjtë të Mekkes.

### D. MARTESA DHE SHKURORËZIMI

Është imperativ fetar dhe etik për të gjithë meshkujt dhe femrat që të martohen.<sup>16</sup> Paja e lartë, mungesa e banesës, arsimimi dhe punësimi nuk duhet të jenë pengesë për martesën e asnjërës prej gjinive. Këto janë bërë pengesa në Perëndim për shkak të parapëlqimit të lartë të Perëndimit ndaj të arriturave materiale dhe interesimit të vogël të popullit perëndimor që kanë për virtytin seksual. Meqë njësia familjare është bërthamore, për bashkëshortët e ardhshëm është e domosdoshme të arrijnë pavarësinë ekonomike qysh para martesës. Familja islame, *per contra*, përbën modelin e zgjeruar që përfshin prindërit, gjyshërit, burrat dhe gratë e tyre si dhe

---

<sup>13</sup> "(Oj gra) mos ekspozoni bukurinë tuaj si dikur në kohën e injorancës (së paraislamit)!" (el-Ahzab:33); "Po thuaju besimtarëve t'i ulin shikimet e tyre dhe të kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të vet. Ajo është punë më e pastër për ata, kurse All-llahu është, me siguri, i informuar se ç'bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve le t'i ulin shikimet dhe të kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të vet, dhe le të mos i ekspozojnë stolitë e tyre, përveç asaj që edhe ashtu është e jashtme (duket). Le t'i mbulojnë krahërorët e tyre me mbulesa..." (en-Nur:30-31).

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> "(Gratë) le të mos ua tregojnë zbulimet e tyre askujt, përveç bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre..." (en-Nur:31).

<sup>16</sup> "Edhe një argument tjetër i Tij është se Ai, nga lloji juaj, krijon bashkëshorte që të gjeni prehje pranë tyre dhe ndërmyet jush mbjell dashuri dhe mëshirë. Ky, me të vërtetë, është argument për njerëzit që meditojnë" (er-Rum:21).

fëmijët. Nisur nga fakti se gratë, sipas *Sheri'atit*, gëzojnë të drejtën të mirëmbahen nga burrat e tyre apo nga ata për të cilët ato janë të varura dhe meqë Islami, në pajtim me sistemin patriarkal, e ka ngarkuar mashkullin e rritur për kujdesin ndaj grave, shumë meshkuj dhe femra muslimane martohen në moshë të re. Ata, zotësinë e bashkëshortit që personalisht ta fitojë pavarësinë ekonomike para martesës e konsiderojnë si jorelevante për çështjen e martesës. Për fat të keq, rinia muslimane po perëndimizohet me një shpejtësi alarmante dhe si rezultat i kësaj ndër ta është popullarizuar shumë këmbëngulja për pavarësi ekonomike personale dhe për shtyrje të martesës deri pas arritjes së kësaj pavarësie. Ky është një zhvillim i trishtueshëm dhe tragjik. Së pari, pavarësia ekonomike personale nuk është diçka e keqe në vetvete, por i tillë mund të jetë kriteri i vlerës që qëndron pas saj. Pranimi i saj si një ideal i domosdoshëm paraqet një supozim të një botëkuptimi materialist, kurse përkrahja e saj nënkupton parapëlqim të familjes bërthamë ndaj asaj të zgjeruarës. Kjo, sipas radhës, është rezultati i një individualizmi dhe subjektivizmi të tepruar. Pavarësia ekonomike personale të shumtën e herëve është diçka më shumë se parakusht i mosdisiplinimit dhe i pamundësisë për disiplinim. Së dyti, shtyrja e martesës të dy gjinitë ia ekspozon tundimit. Së treti, në familjen e zgjeruar, martesë e hershme nuk i pamundëson kërkesat e bashkëshortëve. Që të dy kanë mundësinë të ndjekin shkollimin a punën, sepse në shtëpi gjithnjë do të ketë të afërt të dashur që do t'i drejtojnë punët e shtëpisë dhe që do t'i rrisin fëmijët. Islami, pra, të gjithë muslimanëve u rekomandon që të martohen dhe këtë ta bëjnë në moshë të re dhe gjithnjë të zgjedhin jetesën në familjen e zgjeruar.

## E. FAMILJA E ZGJERUAR

All-llahu xh.sh. familjen e ka krijuar në formën e saj të zgjeruar. *Sheri'ati* atë e ka ngjeshur me legjislacion duke i përcaktuar saktë të varurit, mbështetja dhe mbajtja e të cilëve është e obligueshme, dhe shpërndarjen e të drejtave trashëgimore ndër ta.<sup>17</sup> Thënë në përgjithësi, i varur mund të quhet çfarëdo një farefis, pa marrë parasysh sa e largët është lidhja me të, me kusht që të jetë nevojtar dhe të mos ketë kushëri të rritur mashkull më të afërt me të sesa farefisi në fjalë. Përparësi kanë: gjyshi, gjyshja, nipi, mbesa, mixhallarët / dajallarët, si dhe fëmijët e tyre. Kushërinjtë nga babai kanë përparësi ndaj kushërinjve nga nëna. Në praktikë, familja muslimane është e përbërë prej nja njëzet e më tepër anëtarësh dhe banon në një shtëpi shumëdhomëshe me një kuzhinë dhe një *dīvān* (sallon), ku të gjithë anëtarët mblidhen përreth më të vjetërve dhe ku bëhet pritja e mysafirëve.

Familja muslimane nuk vuan nga hendeku / konflikti i brezave, sepse tri breza jetojnë së bashku. Kështu që, shoqërorizimi dhe akulturimi i të rinjve gjithnjë është i plotë duke garantuar përçimin e traditës dhe të kulturës me sa më pak tjetërsim të mundshëm. Këtu, e kaluara është përnjëmend në kontakt me të tashmen dhe të ardhmen. Një përparësi tjetër vendimtare e familjes së madhe (të zgjeruar) është se ajo anëtarëve të saj u siguron shoqërim të menjëhershëm kurdo që të dëshirojnë dhe në të zakonisht ka mjaft për të zgjedhur sipas temperamentit mbizotërues. Në të gjithnjë gjendet dikush për të luajtur, për të bërë shaka, për të diskutuar, për të kundruar, për të qarë e për të shpresuar. Kurse kjo është një parakusht vendimtar për shëndetin shpirtëror e mendor. Familjes së zgjeruar asnjëherë nuk i mungon

---

<sup>17</sup> Konsulto çfarëdo një tekst të *Sheri'atit*, për shembull atë të el-Xheziriut, *el-Fikhu 'ale'l-Medhāhibi'l-Erba'ah*, për hollësitë e të drejtës trashëgimore islame.

elementi fëmijë, elementi i rritur, elementi femër, elementi mashkull dhe elementi plak që është më i urtë dhe më me përvojë se të tjerët.

Është e vërtetë se familja e zgjeruar anëtarëve të saj u imponon disiplinën dhe flijimin e ndërsjellë. Ajo, nganjëherë, e redukton edhe intimitetin e tyre. Mirëpo, jeta dhe kjo botë nuk na lejojnë të bëjmë jetë pa disiplinë apo pa sakrificë, sikur bota të jetë krijuar vetëm për një person. Vërtet, është mirë ta disiplinosh vetveten dhe të sakrifikosh me shpirtin hapur për të tjerët. Më e mira për ne është që të mësohemi ta disiplinohet vetveten në shtëpi, në duart e atyre që na duan dhe i duam, sesa në duart e të huajve.

## **F. GRUAJA ME PROFESION DHE PUNËTORJA ISLAME**

Aq shumë femra muslimane po e imitojnë Perëndimin në kërkimin e një profesioni nëpërmjet të cilit do ta arrinin pavarësinë ekonomike dhe lirinë personale, saqë ndjehemi të detyruar të themi diçka lidhur me qëndrimin e Islamit në këtë drejtim.

Për sa i përket shumicës dërrmuese të femrave muslimane, s'ka dyshim se ato tregojnë prirje për një profesion të plotë e të vazhdueshëm si zonja shtëpie / amvisë dhe si nëna. Na duket e kotë të theksojmë se profesioni i këtillë kërkon shumë më shumë përgatitje se çdo një profesion tjetër jashtë shtëpisë. Ta përshkruash këtë vetëm me termat gatim / gjellëtari dhe punë të përditshme të shtëpisë, do të ishte një shtrembërim i këtij profesioni fisnik. Ai përfshin kujdesin për njerëzit, qofshin pleq a të rinj; kurse kjo është puna më e vështirë në botë. Kërkon gjithë urtësinë e pjekur, inteligjencën, mjeshtërinë artistike, krijimtarinë, zgjuarsinë dhe përvojën që mund ta ketë personi. Trajnimi / përgatitja, natyrisht, vlen për gjithë kohën që personi mund ta harxhojë për të, qoftë të bëjë me disiplinën e amvisërisë apo të arsimit, letërsisë, arteve, historisë, psikologjisë dhe kulturës.

Edhe pse amvisëria, lindja dhe rritja e fëmijëve është një profesion universal, mbetet e vërtetë se ai nuk i shteron energjitë e femrës sa të jetë gjallë. Anëtarësimi i saj në familjen e gjerë, qoftë nga ana e saj qoftë nga ana e burrit, do t'i gjejë asaj ndihmës e me këtë edhe shumë kohë të lirë. Telashet për kujdesin e fëmijëve nuk mund të zgjasin më tepër se dy a tri dekada, kurse jeta e saj mund të jetë edhe tri dekada të tëra më e gjatë. A është e drejtë që femrat muslimane ta harxhojnë këtë kohë të vlefshme në thashethemet dhe muhabetet familjare duke qenë se kanë mundësinë që me talentin dhe energjitë e tyre t'i ndihmojnë *ummetit*? Po kështu, ka femra që nuk kanë aq fat sa të marohen, të kenë fëmijë apo edhe të jetojnë në familje të gjerë. E tani, si e parashikon Islami jetën e këtyre femrave?

Çdo femër, si çdo mashkull, sipas talentit dhe prirjeve më të mira që ka, duhet ta bartë barrën e shërbimit ndaj All-llahut xh.sh. Kjo detyrë sot është imperativ i dyfishtë për shkak të zvetënimit dhe përgjumjes së *ummetit*. Askush nuk mund dhe nuk duhet të kursehet. Rrethanat tona të sotme kërkojnë që çdo grua të ushtrojë së paku një profesion gjatë një pjese të jetës së saj. Kjo mund të jetë gjatë ditëve të saj studentore, gjatë periudhës së amësisë së saj nëse jeton në familje të madhe e të gjerë apo pas periudhës së amësisë.

Detyra e parë e saj është t'i nënshtrohet përgatitjes si një nëpunëse islame, ta zgjojë mendjen e ta ushqejë atë me urtësi islame, ta disiplinohet e ta ushtrojë vetveten në punën islame dhe ta përgatisë veten për punë të tilla që do të mund t'ia caktonte lëvizja islame. Ajo duhet t'i zbulojë mjeshtëritë për t'i zgjuar e mësuar muslimanët e tjerë dhe për t'i mobilizuar ata në shërbimin e

kauzës hyjnore. Ajo gjithashtu duhet t'i zhvillojë zotësitë që i kërkon puna shoqërore në qytet dhe në fshat. Me anë të punës së saj shoqërore ajo do të duhej t'i vetëdijesonte njerëzit për detyrat e tyre islame dhe t'u ndihmonte atyre duke i mësuar dhe duke u bërë shembull i mirë në kryerjen e shërbimeve që muslimanët ia kanë borxh All-llahut xh.sh. dhe *ummetit*. Praktikisht çdo fushë e veprimtarisë është e hapur dhe ka nevojë për të. Ka një sërë profesionesh që mund t'i ushtrojë vetëm ajo; mirëpo shoqëria muslimane ka shumë më tepër nevojë për punëtoren islame sesa ndonjë mobilizim i femrave që mund ta sjellë në këtë gjeneratë.

Nga anglishtja:  
Mr. Rejhan Neziri